Numër: 01/273
Datë: 19.05.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.05.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** ankesa Nr.01/169 e datës 13.04.2023, e parashtruar nga institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, me adresën: Fshati Sfaraçak i Ulët nr.11, 42000, Vushtrri, Republika e Kosovës, për ndryshimin e pikës 1.2 **Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit;** dhe pikës 1.3 **Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore– aromatike** të vendimit, me numër: 01/130 të datës 31.03.2023 të Këshillit Drejtues të AKK, si më poshtë:.

   1.1 **Akreditohet** institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë se Kosovës – IADK, me adresën: Fshati Sfaraçak i Ulët nr.11, 42000, Vushtrri, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 27.03.2023 deri 26.03.2026, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). **Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri ne katër (4) grupe, gjithsejtë 15 kandidatë brenda vitit dhe

   1.2 **Akreditohet** institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë se Kosovës – IADK, me adresën: Fshati Sfaraçak i Ulët nr.11, 42000, Vushtrri, Republika

e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 27.03.2023 deri 26.03.2026, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) **Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore- aromatike,** Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri ne katër (4) grupe, gjithsejtë 15 kandidatë brenda vitit.

2. **Pika 1.1** e dispozitivit të Vendimit Nr. 01/130 të Datës 31.03.2023, i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve mbetet e pa ndryshuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë se Kosovës - IADK, për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK ka pranuar vendimin nr. 01/130 të datës 31.03.2023, i Këshillit Drejtues të AKK-së, me datën 04.04.2023.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me 01/130 të datës 31.03.2023 të Këshillit Drejtues të AKK-së, ka atakuar pjesërisht dy pikat të këtij vendimi, më saktësisht pikën "1.2 Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahet vetëm një (1) grup, gjithsejtë 15 kandidatë brenda vitit; dhe pikën "1.3 Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore- aromatike, Niveli III sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 6 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit deri me pesëmbëdhjetë (15) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahet vetëm një (1) grup, gjithsejtë 15 kandidatë brenda vitit".

Institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK, me datë 13.04.2023, parashtron ankesën me numër protokolli Nr.01/169 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të vendimit Nr.01/130 të datës 31.03.2023.

Këshilli Drejtues i AKK-së, pasi ka shqyrtuar të gjitha dokumentet, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga institucioni Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës-IADK, për pikat 1.2 dhe 1.3 të vendimit Nr.01/130, i datës 31.03.2023 **është e bazuar,** sepse:
Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoi pretendimet ankimore të institucionit Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK, që pretendohet se: pikat 1.2 dhe 1.3 të vendimi nr. Nr.01/130, i datës 31.03.2023 duhet të ndryshohet.

Administrimi i provave: Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Vendimi Nr.01/130, i datës 31.03.2023, i Këshillit Drejtues të AKK-së; Ankesën me numër protokolli Nr.01/169, e datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në AKK; Emali i zyrtar i datës 14.04.2023, dërguar nga zyrtarja e AKK drejtuar ekipit të ekspertëve për kualifikimet 1.2 Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit; dhe 1.3 Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore- aromatike, ku të bashkëlidhura kanë qenë Ankesa Nr.01/169, e datës 13.04.2023, Email zyrtar i datës 14.04.2023 së bashku me shkresën/përgjigjen e ekipit të ekspertëve të kualifikimeve 1.2 Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit; dhe 1.3 Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore-aromatike, ku përgjigja nga ekipi është:
"Me vendimin nga Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve kemi qenë të angazhuar si ekspert të jashtëm për vlerësim në procesin e akreditimit dhe validimit të profileve "Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të bimëve mjekësore- aromatike" dhe "Punëtor për mbledhje, kultivim dhe përpunim të frutave të malit, niveli III KKK" në Institutin për zhvillimin e buqësisë së Kosovës – IADK në fashtin Sfaraçak, komuna e Vushtrrisë. Ekipi i ekspertëve shte në përbërje të Muzafer

Luma, Demë Mehmetaj dhe Blerim Haliti për fushën e sigurimit të cilësisë (ekspertë të jashtëm), Donjeta Nimani dhe Bleta Kadriu (eksperte nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve).

Vizita në IADK është realizuar me datën 28 Tetor 2022 ku janë zhvilluar takime me menaxhmentin e qendrës dhe trajnerët/instruktorët e profileve.

Bazuar në dokumementacionin e prezantuar dhe vizitës në terren, me 14 Nëntor 2022 ne kemi dërguar draft raportet për validim dhe akreditim për të dy profilet në AKK të cilat edhe janë përcjellur në IADK.
Me 18 Nëntor 2022, IADK i drejtohen AKK me komentet në draft raportet për validim dhe akreditim.
Kontesti themelor kishte të bënte me numrin e kandidatëve për një grup dhe grupet e kandidatëve brenda një viti.
Eksperët, duke konsideruar se këto kualifikime janë specifike dhe ndërlidhen edhe kushtet e kultivimit të bimëve, fillimisht kishin vlerësuar se "Duke pasur parasysh specifikat e kualifikimit, numri i kandidatëve për grup mund të jetë maksimum 15 kandidatë dhe vetëm një grupe brenda vitit mund të trajnohet/certifikohet. Specifikat e kualifikimit ndërlidhen me kohën e fillimit të kultivimit të bimëve (muaji mars) deri te paketimi i tyre (muaji shtator)".
Pas shqyrtimit të komenteve, ekpertët vendosën që "Numri i kandidatëve për grup mund të jetë maksimum 15 kandidatë dhe brenda vitit mund të trajnohen/certifikohen deri 4 grupe".

Sqarim

Raportet e modifikuara (finale) sipas komenteve dhe kërkesës së IADK i janë derguar AKK me 21 Nëntor 2022. Me këtë rast është bërë një lëshim, sepse modifikimet janë bërë vetëm në raportet për validim, dhe jo edhe në raportet për akreditim. Kjo është lehtësisht e verifikueshme, sepse raportet janë dërguar përmes postës elektronike.

Përfundimisht, kërkojmë nga AKK të pranoj kërkesën e IADK, rrjedhimisht edhe të rishikohet vendimi i Këshillit Drejtues i AKK i datës 31.03.2023, dhe të i mundësohet Institutit të regjistroj deri në 4 grupe brenda vitit me maksimum 15 kanidatë për një grup".

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në legjislacionin në fuqi si dhe në vlerësimin e ekspertëve vlerësues të AKK të dhënë pas parashtrimit të ankesës së institucionit Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës– IADK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa

kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë se Kosovës- IADK, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar KD së AKK